



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 510/15 Prot

Tiranë, më 19.11.2020

**V E N D I M**

Nr.152, datë 19.11.2020

***Mbi përfundimin e hetimit administrativ për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit Nr. 1141/12 datë 07.07.2020, të Komisionit të Disiplinës të ISHPSHSH-së, për largim nga shërbimi civil të nëpunësit \*\*\*\*\*.***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procesit të verifikimit të një kërkesë të paraqitur prej nëpunësit, \*\*\*\*\*.

**Vërej se:**

Nëpunësi \*\*\*\*\* , nëpërmjet një kërkesë protokolluar me nr. 510/10 prot., datë 30.07.2020, ka ngritur disa pretendime për parregullsi në zhvillimin e procedurës për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, nëpërmjet dhënies së masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, mbi bazën e fakteve të paprovuara si dhe në shkelje të procedurës së kërkuar nga ligji.

Punonjësi gjithashtu pretendon se kërkesa e eprorit direkt, i cili në të njëjtën kohë paraqitet edhe si Kryetar i Komisionit të Disiplinës, e emërtuar “Relacion monitorues i punës së Drejtorisë Rajonale ISHPSHSH-së Tiranë”, nuk është mbështetur në ligj dhe në prova, për pasojë iniciimi i procedurës disiplinore është i kundërligjshëm dhe në shkelje të hapur të parimit të proporcionalitetit. Po kështu ngrihet pretendimi se rubrika e komenteve të Zyrtarit Raportues në formularin e vlerësimit të punës, është plotësuar pas afatit ligjor, për të rënduar pozitën e tij dhe justifikuar dhënien e masës më të rëndë disiplinore.

Pas marrjes së informacionit të mësipërm është kryer verifikimi paraprak i këtij rasti, mbi bazën e dokumentacionit të mëposhtëm:

Me kërkesën e Komisionerit, nga ana e institucionit, janë dërguar materialet përkatëse me shkresën nr. 1958/1 prot., datë 25.09.2020, *“Kthim përgjigje shkresës 510/1prot., datë 21.09.2020”* dhe njëkohësisht, DAP me shkresën nr. 4337/1 prot., datë 05.10.2020 *“Kthim përgjigje shkresës 510/1prot., datë 21.09.2020”*.

Në aktet e dërguara përfshihen: relacioni monitorues i punës së Drejtorisë Rajonale të ISHPSHSH-së Tiranë (*shkresa nr.1141 prot., datë 08.06.2020 miratuar nga Kryeinspektori*), i vijuar më tej me vendimin për fillimin e procedimit disiplinor, akti nr. 1141/1prot., datë 08.06.2020 i Kryeinspektorit në cilësinë e eprorit direkt dhe përcjelljen e shkeljes disiplinore Komisionit të Disiplinës, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga organi disiplinor, (*vendimi nr. 1141/12 datë 07.07.2020, i Komisionit të Disiplinës të ISHPSHSH*), për marrje masë disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”*.

Komisioni i Disiplinës, ngritur me urdhrin nr. 64 (1141/2 prot.) datë 08.06.2020, *“Për krijimin e Komisionit Disiplinor”*, të Kryeinspektorit të ISHPSHSH, rezulton se ka përbërje të rregullt, sipas përcaktimit të pikës 2, të kreut I, *“Organet disiplinore”*, të vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”*, i ndryshuar.

Me shkresën nr. 1141/3 prot., datë 08.06.2020, *“Njoftim procedim disiplinor”*, ankuesi, është njoftuar për fillimin e ecurisë disiplinore për shkelje shumë të rënda në shërbimin civil, të parashikuar nga pika 2, e nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe njëkohësisht, me shkresën nr. 1141/4 prot., datë 09.06.2020 *“Njoftim”*, Kryeinspektori i ISHPSHSH, ka njoftuar DAP-in për fillimin e një procedimi disiplinor duke kërkuar pjesëmarrjen e një përfaqësuesi të këtij institucioni në cilësinë e anëtarit të KD (*DAP me autorizimin e tij nr. 2525 prot., datë 12.06.2020, ka dërguar përfaqësuesin e tij*).

Në seancat dëgjimore të caktuara nga KD për shqyrtimin e shkeljes disiplinore, nëpunësi në procedim është përfaqësuar me avokat, i cili i ka paraqitur organit disiplinor sqarimet me shkrim rreth shkeljes së pretenduar. Në përfundim të diskutimeve dhe pas analizës së dokumentacionit, Komisioni i Disiplinës ka arritur në përfundimin se punonjësi \*\*\*\*\* ka kryer shkelje shumë të rëndë disiplinore, parashikuar nga pika 2/a, e nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar e mbi këtë bazë, në përfundim të procedurës, nëpërmjet aktit administrativ nr. 1141/12 datë 07.07.2020, Komisioni i Disiplinës ka vendosur marrjen e masës disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”*, ndaj punonjësit në fjalë, duke renditur në përmbajtjen e tij një sërë shkaqesh e rrethanash, nga të cilat mund të përmendim:

- *Kontrolli i fundit i KLSH-së, kryer pranë ISHPSHSH-së, nga data 21.01.2020 deri 12.03.2020 (për periudhën shkurt 2019 - nëntor 2019), ka evidentuar problematika të thella, në procesin e punës së Degës Rajonale të ISHPSHSH, Qarku Tiranë;*
- *Monitorimi i vazhdueshëm i punës bërë nga Drejtoria Qendrore e ISHPSHSH-së, mbedhjeve e takimeve të zhvilluara me Kryeinspektorin, komunikimi ndërmjet postës elektronike zyrtare, i janë bërë disa herë prezentë çështje të mosrespektimit të detyrimeve e kompetencave ligjore të rolit të Kryeinspektorit Rajonal të këtij nëpunësi;*
- *Në sistemin “e-inspektimi”, rezultojnë gjithsejt 20261 inspektime të kryera në 8758 subjekte ekonomike, ndërkohë që kjo degë ka nën juridiksion rreth 49000 subjekte aktive, rezultojnë inspektime të përsëritura të cilat zënë një peshë të madhe në subjektet aktive prej 10% të subjekteve;*
- *Mosfunksionimi në të gjitha hallkat e procesit të rolit të Kryeinspektorit Rajonal, ka reflektuar deformim të procesit të inspektimit në degë, duke mos konsideruar historikun e inspektimeve të kryera më parë për subjektet, në të cilat janë lënë vendime të mëparshme me detyra për t’u realizuar;*
- *Mungesa e një analize risku bazuar në historikun e inspektimeve të subjekteve ekonomike që kjo degë ka nën juridiksion, ka çuar shpesh herë në planifikime të pabazuara, duke sjellë frekuenca të inpektimeve abuzive ndaj subjekteve, 10 % e subjekteve janë planifikuar mbi 4 herë brenda vitit për inspektim, e për më tepër janë subjekte me risk të ulët, parë nga kontrolli i historikut të inspektimeve në dosjet e subjekteve ....), etj.*

Më tej, në zbatim të pikës 20, kreu II, “*Procedura disiplinore*”, të vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*”, i ndryshuar, vendimi për marrje mase disiplinore i është njoftuar nëpunësit \*\*\*\*\*\*, si dhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse.

Gjatë zhvillimit të këtij hetimi administrativ, është konstatuar gjithashtu se nëpunësi në fjalë, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesë padi me objekt shfuqizimin e aktit administrativ nr. 1141/12 datë 07.07.2020, të Komisionit të Disiplinës të ISHPSHSH, për dhënien e masës disiplinore, largim nga shërbimi civil.

Gjithashtu edhe DAP, në përgjigjen e tij, ka njoftuar Komisionerit se pranë tij është përcjellë fletëthirrja me nr. akti 2827, datë 10.09.2020 e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nga ku njoftohet për t’u paraqitur si person i tretë, në këtë proces gjyqësor.

Nisur nga sa më sipër, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr.8116, datë 29.3.1996, “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, sipas të cilit institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se në këtë rast, nuk duhet të vijojë më tej hetimi administrativ, pasi

mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, e cila do të vendosë edhe për zgjidhjen e pasojave të aktit.

**Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të informacionit të regjistruar me nr. 510/11 prot., datë 21.09.2020, në lidhje me largimin nga shërbimi civil të nëpunësit \*\*\*\*\*, për shkak të dhënies së masës disiplinore dhe arkivimin e çështjes, pasi rasti është duke u shqyrtuar nga Gjykata.
2. Të njoftohet për këtë vendim ISHPSHSH, DAP dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**